

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje e pjesëve të këmbimit për automjete për shërbime profilaktike për nevoja të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash 34330000-9, Goma për automjete të lehta 34351000-2

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 5,487,540 (pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet) lekë pa TVSH .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata ". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar " edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më**

pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/broshurë/skedë teknike** nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Në katalog/broshurë/skedë teknike duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. (Nëse katalogu/ broshura/skeda teknike paraqitet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohet nga një përkthim i noterizuar në shqip).

***Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike nga prodhuesi/distributori i autorizuar nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit. Ndërkohë Njësia e Prokurimit në hartimin e këtij kriteri ka mbajtur parasysh të mos kërkojë vetëm katalogët e prodhuesit, por ka mundësuar nëpërmjet përcaktimit të kriterit si më sipër që ofertuesi mund të paraqesë edhe katalogët teknikë/broshura apo skedat teknike të prodhuesit të distributorit të autorizuar (...);”, AK ka vlerësuar se katalogët /broshurat/ skedat teknike mund të jenë nga prodhuesi ose distributori i autorizuar. Në mënyrë që katalogu të jetë i besueshëm dhe të përmbajë informacion të saktë dhe të plotë për produktet e*

ofruara, AK vlerëson të nevojshme që katalogët /boshura/skedat teknike të jenë të lëshuara nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/broshurës/ skedës teknike nga prodhuesi/distributor i autorizuar nga prodhuesi siguron disa avantazhe:

Besueshmërinë e informacionit pasi një dokument i lëshuar nga prodhuesi ose një distributori i autorizuar garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike -Siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit.

Në përfundim për të qenë korrekt dhe për të siguruar një proces të drejtë dhe transparent, është e nevojshme që të kërkohet që katalogu /broshura/ skeda teknike të jenë të lëshuar nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar nga prodhuesi.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Katalogu /broshura/ skeda teknike do të shërbejnë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të artikujve objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e gomave** se garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 40000 (dyzet mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në rastin konkret gomat është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e baterive** për jo më pak se 24 muaj nga dita e furnizimit, si dhe marrjen përsipër të zëvendësimit të baterive me defekt për shkak të prodhimit gjatë zbatimit të kontratës, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se do ta shoqërojë mallin me çertifikatën e garancisë së baterive në momentin e dorëzimit të tij tek autoriteti kontraktor përfitues pas lidhjes së kontratës

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar në*

rastin konkret bateritë është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në çdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ushtron aktivitetin e tij tregtar në fushën objekt prokurimi duke zbatuar normat e sistemit të menaxhimit të cilësisë.

Për këtë duhet të paraqesë:

- a. **Çertifikatë ISO 9001:2015 ose e përditësuar** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohej që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Përgjegjëse për hartimin e specifikimeve teknike janë struktura të specializuara/ Grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për objektin që prokurohet, të ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".**

Specifikime Teknike

<u>Nr.</u>	<u>Përmasat e gomës</u>	<u>Tipi i gomës</u>	<u>Nr. Shtresave (PR)</u>	<u>Indeksi</u>		<u>UTOG</u>	<u>Për Përdorim</u>	<u>NJËSI</u>	<u>Sasi</u>
				<u>Peshë</u>	<u>Shpejtë-sisë</u>				
<u>II. Goma në përdorim për Autovetura 2x4; 4x4 (SUV)</u>	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<u>1</u>	<u>205/60 R16</u>	<u>TL</u>	-	<u>96</u>	<u>H</u>	<u>440/AA/A</u>	<u>katër stinët</u>	<u>copë</u>	<u>34</u>
<u>2</u>	<u>225/65 R17</u>	<u>TL</u>	-	<u>102</u>	<u>H</u>	<u>420/A/A</u>	<u>katër stinët</u>	<u>copë</u>	<u>4</u>
<u>3</u>	<u>235/55 R18</u>	<u>TL</u>	-	<u>97</u>	<u>V</u>	<u>560/A/A</u>	<u>katër stinët</u>	<u>copë</u>	<u>20</u>
<u>4</u>	<u>235/55 R19</u>	<u>TL</u>	-	<u>105</u>	<u>V</u>	<u>500/A/A</u>	<u>katër stinët</u>	<u>copë</u>	<u>16</u>
<u>5</u>	<u>235/50 R19</u>	<u>TL</u>	-	<u>98</u>	<u>H</u>	<u>400/A/A</u>	<u>katër stinët</u>	<u>copë</u>	<u>30</u>

<u>6</u>	<u>265/65</u> <u>R17</u>	<u>TL</u>	-	<u>112</u>	<u>H</u>	<u>500/A/</u> <u>A</u>	<u>katër</u> <u>stinët</u>	<u>copë</u>	<u>4</u>
<u>7</u>	<u>265/40</u> <u>R20</u>	<u>TL</u>	-	<u>94</u>	<u>H</u>	<u>280/AA</u> <u>/A</u>	<u>katër</u> <u>stinët</u>	<u>copë</u>	<u>4</u>
<u>III. Goma në përdorim për automjetet Furgona; Kamioncina.</u>									
<u>8</u>	<u>195/75</u> <u>R16 C</u>	<u>TL</u>	<u>8</u>	<u>107/1</u> <u>05</u>	<u>R</u>	-	<u>katër</u> <u>stinët</u>	<u>copë</u>	<u>152</u>
<u>9</u>	<u>215/65</u> <u>R16 C</u>	<u>TL</u>	-	<u>109/1</u> <u>07</u>	<u>T</u>	-	<u>katër</u> <u>stinët</u>	<u>copë</u>	<u>8</u>
<u>10</u>	<u>225/75</u> <u>R16 C</u>	<u>TL</u>	<u>10</u>	<u>121/1</u> <u>20</u>	<u>R</u>	-	<u>katër</u> <u>stinët</u>	<u>copë</u>	<u>6</u>

- Gomat të jenë të reja (të pa riveshura).
- Në sipërfaqet anësore, çdo gomë duhet të ketë të stampuara këto të dhëna:
 - Prodhuesi (marka)
 - Emërtimi i gomës
 - Përmasat e gomës (sipas kërkesave) dhe profili i batistradës.
 - Indeksi i ngarkesës dhe i shpejtësisë
 - Struktura e gomës (radiale ose diagonale)
 - Tipi i gomës (**Tubeless / Tube Type**).
 - Numri i miratuar **UN/ECE** i prodhuesit të gomës (tregon se prodhimi i gomave bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga UN/ECE)
 - **E** (standardi i BE) ose **DOT** (standardi amerikan).
 - Kodi i prodhuesit të gomës.
 - Kodi i gomës (për shembull **EA** – Kodi i gomës **295/80 R 22.5**).
 - Data e prodhimit (për shembull **1009** - prodhuar në javën e dhjetë të vitit 2009).
- Të jenë të prodhimit për përdorim për 4 stinë, me simbolet dhe shenjat përkatëse. Të kenë të stampuar datën e prodhimit të javës dhe vitit.
- Të jenë të prodhimit jo më herët se 12 muaj nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Gomat e një dimensionit të jenë të gjitha të të njëjtit tip prodhimi

Garancia

Garancia jo më pak se 40.000 (dyzetë mijë) kilometra. Shoqëritë gjatë periudhës së garancisë janë të detyruara të kryejnë zëvendësimin e gomave me defekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga enti pritës i mallit.

Indeksi i peshës:

Indeksi i ngarkesës është një kod numerik i lidhur me ngarkesën maksimale që një gomë mund të mbajë në shpejtësinë e treguar.

Indeksi i peshës së ngarkesës (peshës)													
Tregues i Peshës	Pesha në Kg	Tregues i Peshës	Pesha në Kg	Tregues i Peshës	Pesha në Kg	Tregues i Peshës	Pesha në Kg	Tregues i Peshës	Pesha në Kg	Tregues i Peshës	Pesha në Kg	Tregues i PeshësL ₁	Pesha në Kg
0	45	40	140	80	450	120	1400	160	4500	200	14000	240	45000
1	46.5	41	145	81	462	121	1450	161	4625	201	14500	241	46250
2	47.5	42	150	82	475	122	1500	162	4750	202	15000	242	47500
3	48.7	43	155	83	487	123	1550	163	4875	203	15500	243	48750
4	50	44	160	84	500	124	1600	164	5000	204	16000	244	50000
5	51.5	45	165	85	515	125	1650	165	5150	205	16500	245	51500
6	53	46	170	86	530	126	1700	166	5300	206	17000	246	53000
7	54.5	47	175	87	545	127	1750	167	5450	207	17500	247	54500
8	56	48	180	88	560	128	1800	168	5600	208	18000	248	56000
9	58	49	185	89	580	129	1850	169	5800	209	18500	249	58000
10	60	50	190	90	600	130	1900	170	6000	210	19000	250	60000
11	61.5	51	195	91	615	131	1950	171	6150	211	19500	251	61500
12	63	52	200	92	630	132	2000	172	6300	212	20000	252	63000
13	65	53	206	93	650	133	2060	173	6500	213	20600	253	65000
14	67	54	212	94	670	134	2120	174	6700	214	21200	254	67000
15	69	55	218	95	690	135	2180	175	6900	215	21800	255	69000
16	71	56	224	96	710	136	2240	176	7100	216	22400	256	71000
17	73	57	230	97	730	137	2300	177	7300	217	23000	257	73000
18	75	58	236	98	750	138	2360	178	7500	218	23600	258	75000
19	77.5	59	243	99	775	139	2430	179	7750	219	24300	259	77500
20	80	60	250	100	800	140	2500	180	8000	220	25000	260	80000
21	82.5	61	257	101	825	141	2575	181	8250	221	25750	261	82500
22	85	62	265	102	850	142	2650	182	8500	222	26500	262	85000
23	87.5	63	272	103	875	143	2725	183	8756	223	27250	263	87500
24	90	64	280	104	900	144	2800	184	9000	224	28000	264	90000
25	92.5	65	290	105	925	145	2900	185	9250	225	29000	265	92500
26	95	66	300	106	950	146	3000	186	9500	226	30000	266	95000
27	97.5	67	307	107	975	147	3075	187	9750	227	30750	267	97500
28	100	68	315	108	1000	148	3150	188	10000	228	31500	268	100000
29	103	69	325	109	1030	149	3250	189	10300	229	32500	269	103000
30	106	70	335	110	1060	150	3350	190	10600	230	33500	270	106000
31	109	71	345	111	1090	151	3450	191	10900	231	34500	271	109000
32	112	72	355	112	1120	152	3550	192	11200	232	35500	272	112000
33	115	73	365	113	1150	153	3650	193	11500	233	36500	273	115000
34	118	74	375	114	1180	154	3750	194	11800	234	37500	274	118000
35	121	75	387	115	1215	155	3875	195	12150	235	38750	275	121000
36	125	76	400	116	1250	156	4000	196	12500	236	40000	276	125000
37	128	77	412	117	1285	157	4125	197	12850	237	41250	277	128500
38	132	78	425	118	1320	158	4250	198	13200	238	42500	278	132000
39	136	79	437	119	1360	159	4375	199	13600	239	43750	279	136000

Indeksi i shpejtësisë:

Treguesi i shpejtësisë	Shpejtësia në km/orë	Treguesi i shpejtësisë	Shpejtësia në km/orë	Treguesi i shpejtësisë	Shpejtësia në km/orë
A1	5	D	65	Q	160
A2	10	E	70	R	170
A3	15	F	80	S	180
A4	20	G	90	T	190
A5	25	J	100	U	200
A6	30	K	110	H	210
A7	35	L	120	V	240
A8	40	M	130	ZR	>240
B	50	N	140	Ë	270
C	60	P	150	Y	300
				W	-270

Treguesi i shpejtësisë - Një simbol (kod alfabetik) te cilat sipas një grafiku, tregojnë kategorinë e shpejtësisë në të cilën goma mund të mbajë një ngarkesë që korrespondon me Indeks të ngarkesës së tij në kushtet e shërbimit të specifikuar.


Shpejtësia - Një kategori e caktuar për një gomë, që tregon shpejtësinë maksimale për të cilën vlerësohet përdorimi i gomave.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Nr.	Lloji I baterive	Tensioni	Kapaciteti C20 (Ah)	Rryma CCA (A)		Vendosja e poleve sipas figurës 1 (0,1,2,3,4)	SASIA
				EN	SAE		
1	Bateri P-A	12	165	950	980	4	6
2	Bateri AGM	12	70	760	800	0	8
3	Bateri AGM	12	80	800	850	0	12

1. Koha e prodhimit të baterive të jetë jo më shumë se 6 muaj nga dita e lëvrimit të mallit nga shitësi.
2. Bateritë duhet të jenë të plotësuara me solucion në rastin kur ato janë hermetike.
3. Bateritë e thata (Në rastin kur kërkohen të tilla nga Autoriteti kontraktor) (që kërkojnë mbushje me solucion) duhet të shoqërohen me sasinë e duhur të solucionit mbushës dhe ujit të distiluar (për plotësimin në nivelin gjatë procesit të punës).
4. Në raste specifike, kur nevojiten bateri me pozicion të poleve (+ ose -) në vend ndodhje të kundërta në bateri, shitësi të marrë përsipër zëvendësimin reciprok të tyre.

Specifikime teknike Bateri



Lloji Baterisë	Tensioni nominal	Kapaciteti Rezervë	Kapaciteti C20	Temperatura e operimit	Shkarkimi aktual+25°C-40°C	Rezerva e përdorshme	Jeta ne raft	Cikli jetës	Jeta	Teknologjia	Pesha me elektrolit
100 NA	12 V	190 min	100 AH	-40°C- +60°C		30% DoD	3 muaj	235	24 muaj	Kalciumi Plumbi	29.5kg
110 NA	12 V	200 min	110 AH	-40°C- +60°C	330 A 420s në UF 6V 120S në UF 6V	30% DoD	3 muaj	235	24 muaj	Kalciumi Plumbi	32,5kg

125 NA	12 V	235 min	125 AH	-40°C- +60°C	375 A 420s në UF 6V 120S në UF 6V	30% DoD	3 muaj	235	24 muaj	Kalciumi Plumbi	34 kg
-----------	------	------------	--------	-----------------	---	------------	--------	-----	------------	--------------------	-------

Garancia për te gjitha llojet e baterive;

- 2 Bateritë të garantojnë punë të rregullt deri në 24 muaj nga dita e furnizimit.
- 3 Certifikata e garancisë së baterive të jetë e plotësuar dhe të shoqërojë mallin në momentin e dorëzimit të tij.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

<u>Nr.</u>	<u>EMËRTIMI</u>	<u>MARKETIMI (SAE)</u>	<u>APLIKIMI</u>	<u>SPECIFIKIMET SIPAS</u>		
				<u>API ose OEM</u>	<u>ACEA</u>	<u>Sasia</u>
<u>1</u>	<u>Vaj motori Automjeti</u>	<u>0W20</u>	<u>Motor</u>	<u>SN</u>	<u>A1/B1 ose C5</u>	<u>50 litra</u>
<u>2</u>	<u>Vaj motori Automjeti</u>	<u>0W30</u>	<u>Motor</u>	<u>Land Rover ST JLR.03.5007, Ford ËSS- M2C 950A</u>	<u>C2</u>	<u>100 litra</u>
<u>3</u>	<u>Vaj motori Automjeti</u>	<u>5W30</u>	<u>Motor</u>	<u>SJ</u>	<u>A3/B3, A3/B4 ose A5/B5</u>	<u>400 litra</u>
<u>4</u>	<u>Vaj për kuti shpejtësie</u>	<u>75W80</u>	<u>Kuti shpejtësie</u>	<u>API GL-4</u>	<u>-</u>	<u>40 litra</u>
<u>5</u>	<u>Vaj motori dy kohë</u>	<u>2T</u>	<u>Motor 2 kohësh</u>	<u>TC</u>	<u>JASO FB,FC ose FD</u>	<u>30 litra</u>
<u>6</u>	<u>Antifrizë motori (solucion I përqëndruar)</u>	<u>(-40 C)</u>	<u>Sistem ftohja</u>	<u>SAE J1034</u>	<u>BS6580</u>	<u>38 litra</u>
<u>7</u>	<u>Pastrues i sistemit të gazrave</u>	<u>AdBlu</u>	<u>Katalit, SCR</u>	<u>DIN70070</u>	<u>ISO 2241-1</u>	<u>6000 litra</u>

Mallrat duhen të dorzohen të ambalazuara si më poshte:

- ❖ Ambalazhimi të bëhet në ambalazh të përshtatshëm për ruajtjen dhe transportimin e mallit.
- ❖ Ambalazhi të jetë metalik ose plastik me kapacitet max 20 Litra, për vajin industrial kapaciteti maksimal 100 litra.
- ❖ Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme :
 - ✓ Emri i produktit,
 - ✓ Emri i markës prodhuese,
 - ✓ Adresa e prodhuesit
 - ✓ Data e prodhimit
 - ✓ Pesha neto ne Litra.

Koha e prodhimit te vajit të jëtë jo më shumë se 6 muaj nga dita e lëvrimit të mallit nga shitësi.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*